

# PYETJET MË TË SHPESHTA

## Përgjigje për Pyetjet dhe Mbështetja e Ofruar për Personelin e Shkollës

*Informacioni më poshtë ka vlerë informative dhe nuk shërben si këshillë ligjore. Secili rast është i ndryshëm dhe këshilla ndryshon sipas situatës.*

### 1. Çfarë është gjuha e urrejtjes?

“Gjuha e urrejtjes është ajo mënyrë të foluri e cila ofendon, kërcënon, ose dëmton grupe, bazuar në racën, ngjyrën, besimin fetar, origjinën kombëtare, orientimin seksual, paaftësinë, ose veçori të tjera. “Një grup” në këtë kontekst nënkupton afinitetin tuaj ndaj një grupi, p.sh: Kinezë, Spanjisht folës, Muslimanë, Të zinj, gej/lesbik/transgjindor etj.

### 2. Si do të përballoj gjuhën e urrejtjes në shkollë?

Janë tre burime të thjeshta që mund t’ju ndihmojnë me mjetet e duhura për përballimin e gjuhës së urrejtjes.

- Howard Stevenson i Universitetit të Pensilvanisë, përkatësisht nga Shkolla e Edukimit konstaton se “ që nga zgjedhjet presidenciale ka patur një ngritje të fortë në kërcënimet dhe ngacmimet me sfond racial dhe etnik. Shumë prej këtyre incidenteve kanë ndodhur në shkollat K-12.” Dr. Stevenson ofron këshilla se si edukatorët mund t’i mbrojnë nxënësit e tyre dhe të kujdesen për veten.”

<http://www.gse.upenn.edu/news/educators-playbook/how-confront-hate-speech-school>

- Qendra “The Southern Poverty Law Center”: <http://www.splcenter.org> , është një organizatë për të drejtat e njeriut e përkushtuar në luftën ndaj urrejtjes dhe fanatizmit, si edhe që kërkon drejtësi për pjestarët më vulnerabël të shoqërisë tonë. Përmes përdorimit të çështjeve gjyqësore, edukimit dhe formave të tjera të mbrojtjes, SPLC punon për ditët e mbërritjes së idealit, kur drejtësia dhe mundësitë e barabarta do të bëhen realitet. Aktualisht ata po monitorojnë raportet për ngacmime dhe frikësime pas zgjedhjeve presidenciale, duke ofruar mundësi për luftën kundër urrejtjes. Ata gjithashtu paraqiten edhe si organizata mbështjellëse, ku ofrohen materiale për mësuesit dhe edukatorët mëpërmjet “Teaching Tolerance” ([www.tolerance.org](http://www.tolerance.org)).
- Liga Anti-Shpifjes (The Anti-Defamation League): <http://www.adl.org>. Liga Anti-Shpifjes është themeluar në vitin 1913 "për ndalimin e shpifjes ndaj popullatës Izraelite dhe për garantimin e drejtësisë dhe trajtimit të paanshëm për të gjithë." Tani, si njëra prej organizatave më të mira në vend për çështjet e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, ADL lufton anti-semitizmin dhe të gjitha format e fanatizmit, mbron idealet demokratike dhe të drejtat e për të gjithë njerëzit.

### 3. A është gjuha e urrejtjes e njëjtë si krimi nga urrejtja?

Jo. "Një krim nga urrejtja është një akt i motivuar nga nga paragjykimi, ose urrejtja. Që të jetë një krim nga urrejtja, akti duhet të jetë kriminal- jo thjesht një shprehje e mendimit intolerant. Disa shkelje bëhen krime të urrejtjes, për shkakun që e motivon aktin kriminal. Në shtetin e Pensilvanisë, krimi quhet i kryer nga urrejtja, kur “krime të ndryshme kryhen për shkak të, ose perceptimit të racës, ngjyrës, besimit fetar, origjinës kombëtare, ose të paraardhësve."

### 4. Çfarë duhet të bëj kur jam dëshmitar, dëgjoj, ose bëhem viktimë e një krimi nga urrejtja?

Telefononi menjëherë 911.

## 5. Çfarë duhet të bëj kur në shkollën time ka incidente të gjuhës së urrejtjes, paragjytimeve, përbuzjes, ose dhunës kundër dikujt?

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka politika të cilat mbrojnë komunitetin tonë.

- Politika 102 Edukimi Multirracial-Multikulturor –Gjinor është zhvilluar “për marrjen e njohurive rreth respektimit të gjithë racave, grupeve etnike, klasat sociale, gjinitë, përkatësinë fetare, paaftësinë, orientimin seksual (i supozuar, ose i njohur) dhe identitetin gjinor (i supozuar, ose i njohur)”.
- Politika 252 për Nxënësit Transgjinorë dhe me Gjini të Pakonfirmuar është zhvilluar “të garantojë siguri, barazi dhe drejtësi për të gjithë nxënësit pavarësisht nga identiteti gjinor, ose gjinia e shprehur, kështu që ata mund t’i plotësojnë të gjitha potencialet e tyre njerëzore dhe intelektuale.”
- Politika 248 Ngacmimi. Kjo politikë e përcakton qartë ngacmimin si një sjellje të papëlqyer verbale, me shkrim, grafike, ose fizike, që i referohet gjinisë, moshës, racës, ngjyrës, orientimit seksual (i supozuar, ose i njohur), identitetit gjinor (i supozuar, ose i njohur), origjinës kombëtare, përkatësisë fetare, paaftësisë, të folurit të Anglishtes, statusit social-ekonomik, dhe, ose opinionit politik, ndaj një personi. Ngacmimi është:
  - Kërcënim ose ngacmim, frikësim, ose sulm fizik ndaj një nxënësi tjetër
  - Shkruajtja e mbishkrimeve, që përmbajnë gjuhë ofenduese, e cila poshtëron të tjerët
  - Bërja e shakave fyese, përqeshja e emrit, ose sharjeve drejtuar të tjerëve
  - Stereotipet negative, ose veprimet armiqësore, të cilat janë fyese për të tjerët
  - Materiale grafike, ose me shkrim, që përmbajnë komente, ose stereotipe, të cilat janë postuar, qarkulluar, ose janë shkruar, printuar në rroba, të cilat janë fyese për të tjerët

Ngacmimi duhet të raportohet menjëherë te drejtori i shkollës, ose i caktuari prej tij, ose te çdo pjesëtar i personelit të shkollës, përfshirë mësuesit, këshilltarët, trajnerët, dhe administratorët. Çdo pjesëtar i personelit, i cili merr një raportim të tillë duhet që menjëherë të njoftojë drejtorin, ose të caktuarin prej tij. Nëse pas kësaj, sjellja e tillë vazhdon, ose nëse shkolla nuk ndërmerr veprimet e duhura, nxënësit ose prindërit/kujdestarët, duhet të raportojnë incidentin në linjën e hapur të Drejtorisë Arsimore: 215-400-SAFE.

- Politika 249 Bullingu/ Bullingu Kibernetik është si rezultat i njohjes nga Komisioni i Reformës Shkollore të impaktit negativ që ka bullingu në shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e nxënësit dhe të sigurisë së mjedisit shkollor. Bullingu mund të shfaqet nëpërmjet akteve të qëllimshme fizike, psikologjike, verbale dhe jo verbale, të shkruajtura, ose elektronike, që drejtohen ndaj një nxënësi, ose nxënësis, të cilat manifestohen brenda, ose jashtë mjedisit të shkollës, të cilat janë të ashpra, të vazhdueshme, ose të përhapura dhe kanë efektin si më poshtë:
  - 1. Ndërhyjnë në mënyrë të rëndësishme në edukimin e nxënësit.
  - 2. Krijimin e një mjedisi mësimor kërcënues dhe armiqësor.
  - 3. Përçarje të rëndësishme në mënyrën e operimit të shkollës.

Bullingu karakterizohet nga tre (3) kriteret e mëposhtëme:

1. Është e qëllimëshme, sjellje agresive e qëllimëshme, ose që dëmton të tjerët, dhe
2. Kryhet vazhdimisht gjatë një periudhe kohore, dhe

3. Kryhet në një raport midis personave, që s'kanë të njëjtën balancë force (p.sh një person është fizikisht më i fortë, më i madh, më i shpejtë mendërisht, ose më i fortë nga pikëpamja sociale). Bullingu shfaqet në shumë forma dhe mund të përfshijë një variacion të sjelljeve.

Siç edhe përcaktohet në këtë politikë, bullingu referohet si veprim direkt, ose i tërthortë, i cili mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

1. Fizik – prekje, goditja, shqelmimi, shtytja, sulmi i një personi për të dëmtuar një tjetër.
2. Verbale – thirrja e emrit, ngacmimi, përqeshja, thashemet dhe përhapja e thashethemeve.
3. Jonverbale – kërcënimi, frikësimi, gjestet e turpëshme, izolimi, përjashtimi, kapërdisja dhe bullingu kibernetik (bullingu që shfaqet nëpërmjet përdorimit të pajisjeve të komunikimit elektronik dhe portaleve sociale, emaileve, tekst mesazheve, blogjeve, foto dhe video, tuiteve, ose uebsajteve).

Politika gjithashtu përcakton edhe vendndodhjen e shkollës, duke treguar se çfarë do të thotë, në shkollë, oborrin e shkollës, mjetin e shkollës, në përcaktimin e ndalesave të mjetit të shkollës, në vajtjen dhe ardhjen nga shkolla, ose në çdo aktivitet jashtëshkollor të sponsorizuar dhe mbikëqyrur e sanksionuar nga shkolla.

## 6. Ku mund të gjej informacion rreth diversitetit?

Ka shumë uebsajte, libra, organizata dhe individë që mund t'ju ndihmojnë. Më poshtë po japim një listë të shkurtër, por ndërkohë po përgatitim një material ndihmës për edukatorët, e cila do të përmbajë një listë të përditësuar.

- Toleranca në Mësimdhënie: <http://www.tolerance.org/>. Toleranca në Mësimdhënie ka materiale që lidhen me bisedat me nxënësit rreth situatës pas zgjedhore, punën me fëmijët ku trajtohen çështje të gjithëpërfshirjes dhe qëndrimit ndaj paragjykitimit.
- Mjetet Multikulturore: <http://www.awesomelibrary.org/multiculturaltoolkit.html>  
Këto përmbajnë kërkime në forma bashkëpunimi të grupeve të ndryshme etnike dhe kulturore. Kjo ofron mjetet që diskutojnë pengesat për realizuar bashkëpunimin e kulturave të ndryshme dhe ofrojnë metoda për vlerësimin dhe përmirësimin e modeleve të komunikimit dhe kompetencës kulturore. Këto burime përfshijnë: Fazat e Ndjeshmërisë Ndërkulturore, Si të përdoren Krahasimet e Modeleve Kulturore, Modelet e Komunikimit dhe Supozimet, Përmbledhje e Stileve dhe Vlerave të Normativave të Komunikimit, dhe Dhjetë Mitet që Parandalojnë Bashkëpunimin midis Kulturave të Ndryshme.
- Qendra për Gjuhësinë e Aplikuar (CAL): <http://www.cal.org/>. Qendra për Gjuhësinë e Aplikuar, është një organizatë jo-fitimprurëse, private me qendër në Uashington DC. Misioni i CAL është që të ofrojë materiale me ndjeshmëri kulturore, që lidhen me gjuhën dhe kulturën, në mënyrë që të përmirësojë teknikat komunikuese. Puna e tyre ka si qëllim përmirësimin e edukimit gjuhësor, zgjidhjen e konflikteve me bazë kulturore, realizon studime që bashkojnë gjuhën me kulturën dhe ofron mjetet, që demonstrojnë rëndësinë e të kuptuarit të kulturës në komunikim. Uebsajti përfshin informacion që lidhet me ESL për të rriturit, edukimin dygjuhësh, edukimin e imigrantëve, udhëzime për strehimin dhe tema të tjera, që nxitin kompetencën kulturore në edukim.

## 7. Çfarë është Islamofobia?

“Islamofobia është frika, ose urrejtja ndaj Islamit dhe Muslimanëve. Kjo ka egzistuar prej shekujsh, por është bërë më e theksuar, më ekstreme dhe e rrezikëshme, pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Ky fenomen nxit dhe përhap stereotipet anti-muslimane, diskriminimin, ngacmimin dhe violencën. Kjo ka impakt negativ në pjesëmarrjen e Muslimanëve Amerikanë në jetën publike.”

**8. A ka organizata të cilat mbrojnë dhe mësojnë komunitetin rreth Muslimanëve?**

Po, një prej burimeve më të shquara të kësaj fushe është Këshilli për Marrëdhëniet Amerikano-Islamike (CAIR) : <http://www.cair.com>. “Vizioni i CAIR-it, është që të bëhet një avokat kryesor për drejtësi dhe kuptimin e ndërsjellët. Misioni i CAIR-it është të përforcojë të kuptuarit e Islamit, të nxitë dialogun, të mbrojë liritë civile, të fuqizojë Muslimanët Amerikanë dhe të ndërtojë bashkëpunime, që nxitin drejtësinë dhe kuptimin e ndërsjellët. CAIR ka një departament për monitorimin dhe luftimin e Islamofobisë, ndjek incidentet Islamofobe në të gjithë vendin dhe përmbledh të dhënat për demaskimin e informacioneve të rreme, që janë përhapur rreth Islamit dhe Muslimanëve.

**9. Ku mund të gjej informacion dhe shembuj të praktikave më të mira të punës dhe bashkëjetesës me refugjatët dhe Muslimanët?**

Eshtë një organizatë e dalluar në këtë lëmë e quajtur “Welcoming America”. Ata kanë përpiluar materiale të shkëlqyera dhe një dokument të titulluar *Fqinjësi e Përbashkët. Praktika Premtuese për Forcimin e Marrëdhënieve me Refugjatët dhe Muslimanët*. Ju mund të keni akses në to nëpërmjet [www.welcomingamerica.org](http://www.welcomingamerica.org)

**10. Cili është dallimi midis një imigranti dhe një refugjati?**

“Një refugjat është dikush i cili është i detyruar forcërisht të largohet nga vendi i tij për shkak të përndjekjes, luftës, ose dhunës. Si një refugjat ai ka arsye të ketë një frikë persekutimi për shkak të racës, besimit fetar, kombësisë, pikëpamjeve politike, ose pjesëmarrjes në një grup social të caktuar. Përgjithësisht ata nuk mund të kthehen në shtëpi, ose janë të frikësuar që të kthehen. Dhuna e luftës dhe ajo etnike, tribale dhe ajo fetare, janë shkaqet kryesore të largimit nga vendet e tyre.”

Një imigrant është një person, që ka zgjedhur të largohet nga vendi i tij i origjinës dhe të vendoset në një vend tjetër.

**11. A janë të gjithë imigrantët “ilegalë”?**

Jo. Jo të gjithë imigrantët janë pa dokumenta.

**12. Cila është diferenca midis një personi padokumenta dhe një “ilegali”?**

Termi i duhur për dikë që ka hyrë pa dokumentat përkatëse është padokumenta. Termi ilegal është term jo human.

**13. A mundet që një nxënës pa dokumenta të vazhdojë shkollën?**

Po. Një nxënës pa dokumenta ka të drejtën të shkollohet nëpërmjet arsimit publik falas. Në vitin 1982, Gjykata e Lartë e SH.B.A në çështjen e famëshme “Plyer vs. Doe”, i dha të drejtën një fëmije pa dokumenta të vazhdojë shkollën.

**14. A mundet që një student kolegji pa dokumente të aplikojë për FAFSA?**

Jo. Në çeshtjen “Plyler vs. Doe”, nuk i garantohet një student i pa dokumenta të drejta për studime pas shkollës së mesme. Një student i pa dokumenta nuk mund të përfitojë nga ndihmat që ofron federali. Gjithësesi, shtete të ndryshme kanë ligje të ndryshme për studentët pa dokumenta.

**15. Ku mundet që studentët pa dokumenta të marrin ndihma financiare?**

Janë pesë shtete që ofrojnë ndihmë financiare (jo ndihmë federale) për studentët pa dokumenta: Kalifornia, Nju Meksiko, Teksas, Minnesota, and Uashington. Në Pensilvani, universitete dhe kolegje të ndryshme, kanë rregulla të ndryshme. Në shumicën e universiteteve dhe kolegjeve të Pensilvanisë, nxënësit pa dokumenta mund të regjistrohen, por ata duhet të paguajnë për mësimet, si studentë internacionalë.

**16. A ka ndonjë shtet që i lejon studentit pa dokumenta të vazhdojnë kolegjet dhe universitetet dhe të paguajnë si gjithë studentët e tjerë të shtetit?**

Po. Janë njëzet shtete që e bëjnë këtë: Kalifornia, Kolorado, Konektikat, Florida, Havai, Illinois, Kansas, Meriland, Miçigan, Minnesota, Nebraska, Nju Xhersi, Nju Jork, Oklahoma, Oregon, Rhode Island, Teksas, Utah, Uashington dhe Uiskonsin. Gjithësesi, ka disa diferenca midis këtyre shteteve. “Disa i ofrojnë tarifatat njëllor, pavarësisht statusit—Kalifornia, Havai, Nju Meksiko, Minnesota, Oklahoma, Oregon, Teksas dhe Uashington, të gjitha e kanë një politikë të tillë, pjesa kryesore është, që studentët të kenë ndjekur një shkollë të mesme të shtetit, për 2 ose 3 vjet. Shtetet e tjera e lidhin pagesën me marrjen e DACA—Arizona, Alabama, Massachusetts, Nju Hampshire, Ohio dhe Virginia, kanë vendosur politika duke u lejuar përfituesve të DACA të vendosin residencën për qëllimet e pagesave dhe marrjen e disa përfitimeve nga këto pagesa.”

**17. Po në lidhje me ndihmën financiare? A ka ndonjë shtet që lejon studentët pa dokumentacion të marrin ndihmë financiare nga shteti?**

Po. “Së paku gjashtë shtete—Kalifornia, Minnesota, Nju Meksiko, Oregon, Teksas dhe Uashingtoni—aktualisht lejojnë që studentët pa dokumenta të marrin ndihmë financiare nga shteti.”

**18. A ka shtete ku është e ndaluar për studentët pa dokumenta të paguajnë njëllor si studentët residentë të shtetit?**

Po. “Tre shtete —Arizona, Xhorxhia dhe Indiana—e ndalojnë në mënyrë specifike të njëjtën pagesë për studentët pa dokumente.”

**19. A ka shtete që i ndalojnë studentët pa dokumente të vazhdojnë shkollën, edhe nëse ata paguajnë nga xhepi i tyre?**

Po. Janë tre shtete që i ndalojnë studentët pa dokumente të regjistrohen në universitete dhe kolegje: Karolina e Jugut, Alabama dhe Xhorxhia.

**20. Si mund të ndihmoj dhe inkurajoj nxënësit e mij që të vazhdojnë shkollimin, nëse ata nuk mund të marrin ndihmë financiare?**

Ka një numër organizatash të cilat japin ndihma financiare në mënyrë specifike për studentët pa dokumenta. Disa prej tyre janë:

[www.thedream.us](http://www.thedream.us)

[www.salef.org](http://www.salef.org)

[www.maldef.org](http://www.maldef.org)

[www.latinocollegedollars.org](http://www.latinocollegedollars.org)

## 21. Çfarë është DACA?

DACA është akronim i Veprimi i Shtyrë për Ardhësit në Fëmijëri (Deferred Action for Childhood Arrivals). DACA erdhi si reagim ndaj Kongresit, që nuk kaloi ligjin “Dream Act”, i cili do ti jepte statusin e ligjshëm individëve pa dokumenta, të cilët kanë ardhur si minore në SH.B.A. Në datën 15 Qershor 2012, Presidenti Barack Obama firmosi një urdhër egzekutiv, i cili i adresohet në mënyrë specifike disa njerëzve “ të cilët erdhën në Shtetet e Bashkuara si fëmijë dhe që plotësojnë disa kërkesa” të cilët “ mund të kërkojnë vlerësimin për veprime që shtyhen për një periudhë kohore 2 vjeçare, subjekt i rinovimit. Ata janë të vlefshëm edhe për autorizim pune. Veprimi i shtyrjes është përdorimi i gjykimit të prokurorisë, që të shtyjë veprimet për largimin e një individi, për një periudhë të caktuar kohore. Veprimi i shtyrë, nuk ofron një status ligjor” DACA nuk është ligj.

## 22. Kush mund të aplikojë te DACA?

Aplikimet e Individëve në DACA u nënshtrohen udhëzimeve shumë të rrepta:

- Duhet të ishin nën moshën 31 vjeç deri në 15 Qershor 2012;
- I ardhur në SH.B.A përpara moshës 16 vjeçare;
- Kanë jetuar vazhdimisht në SH.B.A që prej 15 Qershor 2007 deri tani;
- Kanë qenë fizikisht në SH.B.A në 15 Qershor 2012 dhe në kohën e bërjes së kërkesës për t’u marrë në konsideratë për veprim të shtyrë me USCIS;
- Nuk ka pasur status ligjor në datën 15 Qershor 2012;
- Janë aktualisht në shkollë, janë diplomuar, ose kanë certifikatë të GED-it, ose janë veteran i nderuar në rezervë i “Coast Guard” ose i forcave të Armatosura të SH.B.A;
- Dhe, nuk janë dënuar për një krim, keqbërja serioze, ose tre keqbërje të vogla dhe nuk përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare, ose sigurinë publike.

## 23. Unë do të dëshiroja të mësoja më tepër për DACA. Ku mundet që mësuesit të marrin disa informacione të besueshme?

Një burim i rëndësishëm për mësuesit mund të gjendet në uebsajtin e Federatës Amerikane të Mësuesve: <http://www.aft.org/file/2109>

## 24. Ku mund të merrja informacion shtesë për “Dreamers” dhe DACA?

Ju mund të shkoni në [www.unitedwedream.org/dream-university/daca-toolbox](http://www.unitedwedream.org/dream-university/daca-toolbox)

## 25. A ka ndonjë blog ku shkruhet nga/për studentët pa dokumenta?

Po, Jeta ime e (Pa) Dokumentuar: [www.mydocumentedlife.org](http://www.mydocumentedlife.org). “Misioni në Jeta ime e (Pa) Dokumentuar është të japë informacionin e përditësuar dhe materiale për imigrantët pa dokumenta. [Ata] postojnë mundësi fondesh ndihmëse për studentët pa dokumenta, strategji për hulumtimin e sistemit arsimor, informacion se si të aplikoni për “DACA/Advanced Parole”, lajme për DAPA (Deferred Action for Parents of Americans), dhe shumë të tjera. Uebsajti ofron lajme pas zgjedhore dhe çfarë do të thotë kjo për komunitetin pa dokumenta dhe hapat që duhet të ndërmarrin për të mbrojtur veten.”

## 26. Çfarë duhet të bëj nëse një student pa dokumenta, ose një pjesëtar i familjes më paraqet frikën e tij/saj për deportim?

Gjëja e parë është të mos ju kapë paniku. Ka burime, strategji dhe organizata të komunitetit të gatëshme që t'ju asistojnë.

- **Për Nxënësit dhe familjet Meksikane:** Qeveria Meksikane ka një linjë 24/7 për rezidentët meksikanë të cilët kanë nevojë për ndihmë. *Estamos Contigo* Hotline: 1-877-632-6678. Për konsultime dhe mbrojtje, ose çeshtje të tjera të imigrimit, ata mund të kontaktojnë në USA: 1-855-6395 dhe nga Meksika: 001(520)6237874.
- **New Sanctuary Movement:** Nëse ndonjëri shikon, ose është viktimë e bastisjeve në Filadelfia, ata duhet të telefonojnë linjën e urgjencës: 267-333-9530.
- **The Pennsylvania Immigration and Citizen Coalition:** ka informacion të vlefshëm për të drejtat që ka një individ pa dokumenta. Për më tepër informacion vizitoni: <http://www.paimmigrant.org/paisready#Raids>

## 27. A mundet të deportohet një fëmijë?

Po, fëmijët mund të deportohen.

## 28. A mundet që studentët pa dokumenta, familjet dhe miqtë të deportohen menjëherë?

Jo. “Individët pa status, të cilët janë prezent në U.S. kanë disa të drejta ligjore dhe kushtetuese [Ata] kanë të drejtë të seancës dëgjimore dhe një gjykim të rastit [të tyre].”

## 29. Unë do të dëshiroja të sillja folës që t'i adresohet komunitetit të shkollës time. Ku mund të gjej folës të tillë?

Është një listë shumë e shkurtër, por organizatat e mëposhteme bashkëpunojnë dhe mbrojnë të drejtat e imigrantëve.

- Juntos Philadelphia: <http://vamosjuntos.org/>. “Juntos” është një organizatë e komunitetit të imigrantëve Latino, në Filadelfian Jugore (South Philadelphia), që lufton për “të drejtat tona si punëtorë, prindër, të rinj dhe imigrantë. Ne besojmë se çdo qenie njerëzore ka të drejtën e një edukimi cilësor dhe lirinë që të jetojë me dinjitet, pavarësisht statusit si imigrant.”
- Pennsylvania Immigration and Citizens Coalition (PICC): <http://www.paimmigrant.org/> është një grup që bashkon profesionistët, mbrojtësit dhe grupet e imigrantëve nga shtesa të ndryshme për ndarjen e informacionit dhe materialeve, identifikon problemet e përbashkëta dhe bën mbrojtjen për zgjidhje.
- Asian Americans United: [www.aaunited.org](http://www.aaunited.org). AAU punon me komunitetet e Aziatikëve-Amerikanë të Filadelfias dhe në një koalicion më të gjerë multirracial, për edukim cilësor, drejtimin e të rinjëve, kundër dhunës ndaj aziatikëve, të drejtat e imigrantëve dhe çeshtje të kulturës dhe arteve folklorike.
- New Sanctuary Movement: <http://sanctuaryphiladelphia.org/>. Misioni i “New Sanctuary Movement” është të “punojë për t’i dhënë fund padrejtësive kundër imigrantëve, pavarësisht statusit të tyre, të shprehë mirëseardhje për të gjithë dhe të garantojë që vlerat e dinjitetit, drejtësisë dhe mikpritjes janë të gjalla në praktikë dhe të mbështetura në politikë.”

## 30. A do të vazhdojë Filadelfia të jetë Qyteti i “Shenjtë”?

Po. Por tani quhet Qyteti i Amendamentit 4<sup>-t</sup>. Emri i ri akoma reflekton parimet e Qytetit të “Shenjtë”, i cili ndalon pothuajse të gjitha komunikimet midis autoriteve lokale të zbatimit të ligjit dhe autoriteteve federale të imigrimit. Për më tepër informacion shkoni në:

[http://www.philly.com/philly/news/politics/20161111\\_Kenney\\_Philadelphia\\_stays\\_a\\_sanctuary\\_city\\_despite\\_Trump.html](http://www.philly.com/philly/news/politics/20161111_Kenney_Philadelphia_stays_a_sanctuary_city_despite_Trump.html)

**31. A ka tekste bazë të cilat trajtojnë diversitetin dhe përfshirjen?**

Po. <http://perspectives.tolerance.org/central-text-anthology>. “Në qendër të kurrikulës së “*Perspectives*” është Antologjia e Tekstit Qendror, një grumbullim i kujdesshëm dhe rigoroz i teksteve, të cilat ilustronë me shembuj temat kundër paragjytimeve dhe janë në një hap me kërkesat e Standardeve të Përgjithëshme. Këto tekste i nxisin nxënësit për pyetje me kuptim të përbashkët, vlerësimin e shumë pikëpamjeve, analizën dhe kritikën e marrëdhënieve mbi bazën e forcës dhe veprimin për ndryshimin e konditave të panderëshme dhe jo të barabarta. Në shtesë të informacionit me shkrim dhe teksteve të shkruara, Antologjia përfshin tekste të multi-medias (klipe, pod caste, intervista) dhe tekste pamore (kartona, grafikë, fotografi). Çdo tekst në Antologji është analizuar për nivelin e shkallës CCSS dhe është në përputhje me tematikën e “*Perspectives*” dhe standardet kundër paragjytimeve.”

**32. Fëmijët e kopështit dhe ata të klasës së parë, më kanë shprehur frikën se prindërit e tyre do të kthehen mbrapa në vendin e tyre. Si mund t’i ndihmoj ata që të qetësohen?**

Ka një uebsajt të mrekullueshëm, ku nxënësit tanë të rinj mund të lundrojnë në shembuj të ndryshëm: <https://app.gonoodle.com/channels/think-about-it/take-on-the-day?source=search>

**33. Çfarë burimesh mund të përdor të kuptoj gjendjen e imigrantit/minorenit të pa shoqëruar?**

Ju mund të shkoni në: <http://nctsn.org/trauma-types/refugee-trauma/guidance-unaccompanied>. Ky uebsajt do t’ju ofrojë ju një vetëdije më të madhe për traumat e përjetuara nga minorenët/imigrantët e pashoqëruar.

**34. A është duke zhvilluar Drejtorja Arsimore e Filadelfias programe dhe shërbime për informimin e nxënësve, familjeve dhe personelin për çështjet e diversitetit?**

Po. Ne jemi duke organizuar një forum të komunitetit, mundësi të kualifikimit profesional për personelin, mjete për familjet dhe stafin, bibliografi me shënime, një listë me shënime për organizatat e komunitetit, etj.